



Prishtinë, 28.03.2025
Kodi i ZRRE-së: V_2680_2025

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRrE/DMK_V_2630_01_25** i datës 14.01.2025;
- Ankesa e konsumatorit e datës 20.02.2025.

në seancën e mbajtur më datë 28.03.2025 nxori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET** ankesa e konsumatorit A. K., nga Komuna e Gjakovës, si e pabazuar.
- II. MBETET** në fuqi, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRrE/DMK_V_2630_01_25 i datës 14.01.2025.
- III.** Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhet zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me datë 14.01.2025 ka marrë Vendim me nr. ZRrE/DMK_V_2630_01_25 me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e konsumatorit, lidhur me kontestimin e faturës me nr. 06240DGJ – 9003282, në vlerë prej 733.61 €, për shkak të dyshimeve për lexim dhe faturim jo të saktë me njehsorin elektrik me nr. 75484733, ashtu që, në fuqi kishte mbetur Vendimi i Departamentit për Kujdes ndaj Konsumatorëve të KESCO-s, i dt. 25.09.2025.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, konsumatori A. K., brenda afatit ligjor ka paraqitur Ankesë në Bordin e ZRRE-së, për këto shkaqe:

- Nuk qëndron konstatimi se punëtorët e KEDS nuk kanë pasur qasje në pikën matëse;
- Konsumatori ka ngritur dyshime rreth gjendjes së njehsorit, me pretendimet se nuk është duke funksionuar si duhet.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 28.03.2025 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit të datës 20.02.2025; Vendimin e DMK të datës 14.01.2025; Ankesën e konsumatorit në KESCO të datës 19.08.2024; Përgjigjën e KESCO-s të datës 25.09.2024, Ankesën e konsumatorit në DMK të ZRrE-së të datës 15.10.2024; Transaksionet e konsumatorit, Rrjedhën e Energjisë Elektrike dhe Listat e Leximit. Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit/konsumatorit **është e pabazuar**, sepse:

Me datë 28.06.2024, Departamenti i Faturimit në KESCO i ka dërguar konsumatorit faturën me nr. 06240DGJ-9003282, në vlerë prej 733.61 €. Me datë 19.08.2024, konsumatori ka parashtruar ankesë në KESCO duke e kundërshtuar këtë faturë, nën dyshimet për matje jo të saktë të energjisë elektrike me njehsorin me nr. 75484733. Pas shqyrtimit dhe analizimit të ankesës së konsumatorit, Departamenti për Kujdes ndaj Konsumatorëve në KESCO, lëshon një Vendim, me të cilin refuzohet ankesa e konsumatorit, dhe atë duke u bazuar në listat e leximeve, rrjedhës së energjisë elektrike, transaksioneve si dhe procesverbalit nr. 0092578 date 20.08.2024 mbi kontrollimin e njehsorit elektrik nr. 75484733. Me datë 15.10.2024, i pakënaqur me këtë Përgjigje, konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, duke e kontestuar në tërësi faturën 06/2024. Konsumatori i propozon DMK-së që ankesa të aprovohet, ashtu që fatura e kontestuar të anulohet në tërësi.

Bordi i ka analizuar rrjedhën e energjisë elektrike si dhe listat e leximit dhe konstaton se konsumatori ka inspektime të rregullta mujore për leximet e shpenzimeve mujore por që lexuesi i KEDS-it në shumicën e periudhave ka evidentuar se nuk ka qasje në leximin e shpenzimeve. Po ashtu, duhet theksuar se, kjo gjendje faktike është në kundërshtim me nenin 25 paragrafin 1 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike, e ku thuhet se: *“Konsumatori është i obliguar që të ju lejojë qasje në pronën e tij, përfaqësuesve të Operatorit të Sistemit/Furnizuesit, për qëllim të leximit, testimit, inspektimit, instalimit, mirëmbajtjes, riparimit të matësve, kyçjeve dhe pajisjeve përkatëse ashtu si paraqitet në Nenet 28, 29 dhe 30 të Ligjit për Energji.* Rrjedhimisht, qëndron edhe konstatimi i DMK-së se, konsumatori ka vepruar në kundërshtim me këtë dispozitë ligjore, sepse është dashur që të iu lejojë qasje punëtorëve të autorizuar të KEDS në pikën matëse të konsumatorit. Kësisoj, për periudhën kohore që punëtorët e autorizuar të KEDS nuk kanë pasur qasje në pikën matëse të konsumatorit (periudha 12/2022 deri në periudhën 06/2024), i njëjti është faturuar vetëm me taksa. Ndërkaq, fatura e kontestuar e dt. 28.06.2024, me shpenzime prej TL = 4775 kWh dhe TU = 1741 kWh (në këtë muaj konsumatori është lexuar dhe është nxjerrë gjendja reale e shpenzimeve), nuk paraqet shpenzim një muaj të konsumatorit, por paraqet grumbullim të shpenzimeve për periudhat kohore që konsumatori nuk është lexuar dhe faturuar me rregull përkatësisht për periudhat 12/2022 deri në periudhën 06/2024. Po ashtu, vihet re, që konsumatori edhe pas periudhës kontestuese, në disa periudha vazhdon të mos faturohet me shpenzimet e tij reale, por në mënyrë të vlerësuar.

DMK ka shqyrtuar procesverbalin nr. 0092578 date 20.08.2024 të përpiluar nga punëtorët e autorizuar të KEDS-it për kontrollimin e saktësisë së matjes së njehsorit elektrik nr. 75484733 dhe konstaton se pas shqyrtimit të matjes me pajisjen “ZERA” gabimi në matje është **0.24%** e që kjo është brenda kufijve të lejuar të gabimit në matje të përcaktuar me Kodin e Matjes së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes e që është **+/-2.5%**. Në procesverbal po ashtu është evidentuar edhe gjendja e shpenzimeve të



regjistruara ne njehsorin elektrik nr. 75484733 ku TL=007468 kWh dhe TU=002421 kWh dhe se kjo gjendje përputhët plotësisht me gjendjen e faturuar ne periudhën 06/2024.

Pra, nga sa mund të shihet, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të konsumatorit, sepse nga Listat e Leximit u vërtetua fakti që konsumatori nuk u ka mundësuar qasjen punëtorëve të KEDS për lexim dhe faturim të shpenzimeve të tij në baza mujore. Për më tepër, pretendimi pa parregullsi të njehsorit, nuk qëndron si i tillë, sepse, siç u elaborua më lartë, njehsori është inspektuar për saktësi të matjes dhe ka rezultuar brenda kufijve të lejuar të matjes.

Bordi thekson se, bazuar ne shqyrtimin e faturës kontestuese, rrjedhës se energjisë elektrike, listave te leximit dhe se duke pasur parasysh se konsumatori nuk ka faturim te shpenzimeve reale mujore nga periudha 12/2022 deri ne periudhën 06/2024 ka bere shpërndarjen e kWh te faturuar ne periudhën 06/2024, per periudhën 12/2022 deri me 06/2024 dhe konstaton se konsumatorit nuk i takon korrigjim financiar.

Tutje, duke u bazuar në nenin 5 – Furnizimi me Energji elektrike – të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike, *“të gjithë konsumatorët e kanë për obligim që të paguajnë për energjinë elektrike të shfrytëzuar sipas kontratës për furnizim me energji të lidhur me furnizuesin e energjisë, si dhe për tarifat për shfrytëzim të sistemit të miratuara nga ZRRE-ja”*, andaj konsumatori e ka për obligim që të paguaj energjinë elektrike të cilën e ka shpenzuar. Bordi i ZRRE pas analizave të bëra dëshmime dhe argumenteve të paraqitura nga palët , analizimi të transaksioneve, Rrjedhës dhe Listave të Leximit, si edhe Procesverbalin për shqyrtimin e saktësisë së matjes, dhe Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimi të Vendimit ose nga data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Lutfije Dervishi, Anëtare

Gani Buçaj, Anëtar

Arta Isufi, Anëtare

Adnan Preniqi, Anëtar

Vendimi u dërgohet:

- KESCO-s,
- Konsumatorit **A. K.**, dhe
- Arkivit të ZRRE-së